

# NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. GENTI XHOLI

12/10/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 05.12.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Genti Xholi, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 10.12.2019, vendosi: Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Genti Xholi, prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Etleda Çiftja , znj. Firdes Shuli relatore, z. Roland Ilia anëtar, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.